



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1561/ 10 prot.

Datë 26.06.2026

V E N D I M
Nr. 886/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nenkryetar
Anila Malaj	Anetar
Kreshnik Ternova	Anetar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 760/2026 datë 08.06.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: Operatori ekonomik “Eidon-Grup” SHPK me NIPT L91323019S dhe adresë: Rruga Kodra e Diellit, Ndertesa Nr.2, Hyrja 15, Ap.11, 1044 , Selite, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 08.06.2026 , Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 760/2026 ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6681 dhe me nr. 1561/2026 prot., datë 20.05.2026 të operatorit ekonomik “Eidon-Grup” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
 - 2. Të mos pranojë ankesën me nr. 1561/1 prot., datë 21.05.2026 të operatorit ekonomik “Eidon-Grup” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, të dërguar në KPP me shërbim postar.*
 - 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e dokumenteve të tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
 - 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 - 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Eidon-Grup” SHPK.*
 - 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 2142/10 prot., datë 15.06.2026 , protokolluar me tonën nr. 1561/7 prot., datë 17.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.760/2026, datë 08.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.2142/10 prot., datë15.06.2026 , protokolluar me tonën nr. 1561/7 prot., datë 17.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.760/2026, datë 08.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë

monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën, në përputhje me vendimin Nr.760/2026, datë 08.06.2026 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

